





Anketa mbi Impaktin EITI në Komunitet

Sekretariati Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse

Janar, 2016

Pas publikimit të Raportit EITI 2011 dhe Raportit EITI 2012, EITI Albania filloi një fushatë publicitare në media, me transmetime të reklamës EITI në televizionet lokale dhe kombëtare. Në vijim të kësaj fushate më 29 Shtator 2015, Sekretariati Shqiptar EITI startoi një anketim të dytë rreth impaktit EITI në komunitet. Numri i pyetësorëve u rrit nga 500 në 700 pyetësor krakasuar me anketimin e parë që u zhvillua më 23 shtator, 2014. Anketa u zhvillua deri më dhjetor 2015 edhe si një mjet promovimi rreth implementimit EITI në Shqipëri duke bërë të mundur takimet e drejta për drejta me qytetarët e Bulqizës, Librazhdit, Kukësit, Patosit, Fierit, Përrenjasit dhe Tiranës.

Pyetësori konsistoi në 18 pyetje, për të provuar të dhëna se sa njohuri kanë qytetarët e Shqipërisë rreth industrisë nxjerrëse, rreth nismës EITI dhe veprimtarisë së saj, si dhe mbi përfitimet e komuniteteve nga industria nxjerrëse, a është investuar mjaftueshëm në komunitetin e tyre nga të ardhurat që sjell kjo industri në arkën e shtetit.

Pyetjes **“Jeni në dijeni të ndonjë aktiviteti të industrisë nxjerrëse në komunitetin/qytetin tuaj?”**, rezultoi që 90% të anketuarve ishin në dijeni të ushtrimit të aktivitetit dhe kompanive nxjerrëse në komunitetet. Si në shumë vënde dhe në Shqipëri ndjeshmëria ndaj ndotjes së mjedisit është rritur duke e bërë të domosdoshme pyetjen **“A mendoni se këto kompani kanë shkaktuar ndotje të mjedisit në zonën tuaj”**. Numri i përgjigjeve “Jo” dhe “Po” rezultoi 50% me 50%. Kryesisht banorët që jetonin në zonat naftë nxjerrëse ndotjen e mjedisit e konsideronin të lartë.

Pyetjes **“A jeni në dijeni të ndonjë pagese të kryer nga kjo/këto kompani?”** dhe **“A e dini se kush është përfituesi i pagesave?”** tregon qartë që qytetarët kanë shumë pak informacion rreth pagesave të bëra ndaj qeverisë dhe menaxhimit të këtyre pagesave nga ana e institucioneve shtetërore. Pakënaqësia e të anketuarve është shumë e lartë kur ata u pyetën **“Sa mendoni që është investuar në komunitetin/qytetin tuaj nga këto pagesa të marra?”** Mungesa e këndeve sportive, numri i lartë i papunësisë, problemet në infrastrukturë ishin disa nga shqetësimet kryesore të ngritura nga qytetarët për mungesën e investimeve nga të ardhurat e industrisë nxjerrëse.

Mbetet akoma një sfidë për Sekretariatit Shqiptar EITI impakti në komunitet, duke parë një numër të vogël të përgjigjeve “Po” rreth pyetjes **“Keni dëgjuar për Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse ose siç quhet ndryshe EITI Albania?”** Kjo përqindje e ulët e përgjigjeve positive, rreth 30%, na nxit të vijojmë fushatën promovuese më intensivisht në zonat ku operon industria nxjerrëse. Dhe pse Sekretariati Shqiptar EITI publikoi Raportin EITI 2011 dhe Raportin EITI 2012 brënda viti 2014 duke zhvilluar konferenca për shtyp, pjesmarrje në emisione televizive, botime në revista ekonomike, publikime online në faqen zyrtare dhe në rrjete sociale vihet re se qytetarët kanë ndjeshmëri të ulët për të ardhurat e gjeneruara nga industria nxjerrëse në këto vite, të dhëna që i përkasin të kaluarës. Nisur nga kjo, Sekretariati Shqiptar beson se me publikimin e dy raporteve të radhës përkatësisht Raportin EITI 2013 dhe Raportin EITI 2014 brënda viti 2015, ku të dhënat nga industria nxjerrëse janë koherente do të ngjallë më shumë interesin e publikut.

Ishte në interesin tonë të merrnim opinionin e qytetarëve duke i pyetur **“Çfarë mjeti komunikimi do sygjeronit për të përdorur për reklamimin e procesit EITI në Shqipëri?”** Një numër i lartë i të rinjve sygjeruan për Sekretariatit Shqiptar EITI përdorimin më të madhë të hapsirave online, ndërkohë mosha mesatare sygjeroi televizorin si mjet komunikimi për të marrë informacione rreth EITI Shqiptarë. Gjithashtu në sygjerimet e qytetarëve ishte dhe shtimi i seminareve dhe aktiviteteve informuese.

Duke falenderuar të gjithë qytetarët që morrën pjesë në anketën EITI dhe duke marrë në konsideratë të gjitha përgjigjet, transparenca në industrinë nxjerrëse mbetet objektivi kryesor për mirëqeverisjen e burimeve natyrore në dobi të komunitetit.